

## PARATHENIE

Pse u botua shkrimi me titull “ *Pse te mohohet nje e ardhme*”? Idea per raportin me titull : Pse te mohohet nje e ardhme doli nga sesioni i komisionit te kombeve te bashkuara i vititi 1999 mbi te drejtat e njeriut. Save the children paraqiti informacion lidhur mbi menytrat se si ishte dhunuar dhe kompromentuar e drejta per arsim, per femijet Rome, Jevgjite dhe femijet Endacake ne nje numer vendesh Evropiane. Shume njezesh ishin te interesuar te dinin me shume dhe na kerkuan ne te rekomandonim publikime te cilave ata mund t'i referoheshin. Ne zbuluam se kishte disa prej tyre meqe kishte shume informacion nga institutet kerkimore, nga burime qeveritare, nga organizata qe komunitetet e Romeve, Jevgjiteve dhe Endacakeve, nga aktivitetet qe jane zhvilluar ne keto komunitete dhe ky informacion gjendej ne biblioteka, arkiva dhe ne kokat e njerezve ne shume vende dhe ne shume gjuhe te ndryshme.

Shpenzohen shuma te medha parash nga qeverite, nga agjensite nderqeveritare dhe nga Organizatat Joqeveritare Nderkombetare mbi programet qe kane per synim te bejne reforme ne fushen arsimore, ne Evropen qendrore dhe Juglindore, dhe qe kane per qellim te permiresojne situaten e femijve Rome, Jevgjite dhe Endacake ne Evropen Perendimore. Mungesa e nje teksti te mundshem ku te pershkruhej pika e nisjes per shpenzimet qe do te llogariteshin tregonte se ishte veshtire te vleresohej ne se keto programe vertet po sillnin ndryshime pozitive per femijet, Rome, Jevgjite dhe Endacake. Dukej se kishte qindra projekte te vogla, shume prej te cilave ishin risi ne kete fushe dhe te suksesshme. Por ishte e veshtire te thuhej ne se keto iniciativa pilot te suksesshme kishin nje influence te rendesishme per nje afat te gjate ose per nje game me te gjere. Me fjale te tjera shpenzimet per iniciativat eksperimentale pilot po çonin drejt ndryshimeve sistematike?

Save the Children vendosi se ndihej nevoja per nje tekst baze ku te pershkruhej legjislacioni, politika dhe praktika lidhur me arsimimin e femijve Rome, Jevgjite dhe Endacake ne disa vende Evropiane. Raporti me titull *E Ardhmja e Mohuar*, pershkruan ligjet politikat dhe praktiken per periudhen Qershor 2000 deri ne Qershor 2001. Ne synojme qe ky raport te sherbeje si nje etalon per te vleresuar ndikimin qe paten investimet e tanishme dhe ato qe do te behen ne te ardhmen nga Banka Boterore, Bashkimi Evropian, Qeverite Kombetare dhe lokale si edhe agjensite e tjera.

Çeshtjet e trajtuara ne raportin me titull *Pse te mohohet nje e ardhme* kane nje rendesi dhe lidhje te madhe me Evropen bashkekohore. Ato jane tipare qe u duken ne debatet qe çojne drejt zgjerimit te bashkimit Evropian dhe ne aktivitetin e Tryezes se Punes mbi Demokratizimin dhe Te drejtat e Njeriut te Paktit te Stabilitetit per Evropen Juglindore. Mohimi i ruajtjes te se drejtes per arsim per nje numer te madh femijesh Rome, Jevgjite dhe Endacake u theksua ne takimin e UNESCO mbi arsimin per vitin 2000 qe u zhvillua per vendet e Rajonit te Evropes dhe Amerikes se Veriut. Gjithashtu ky problem u theksua dhe ne Konferencen Evropiane kunder racizmit e cila u organizua nga keshilli i Evropes si perгатitje per konferencen boterore te Kombeve te Bashkuara Kunder Racizmit.

Raporti i secilit vend lidhur me temen Pse te mohohet nje e ardhme u koordinua nga nje autor ose editor i vetem. Megjithate, keta autore ose editore u mbeshteten ne shume kontribute ne forme te shkruar ose gojore te marra nga vendet perkatese. Keto drafte projekte u perhapen gjeresisht nga grupi koordinues dhe u kerkua te beheshin komente nga individe ne komunitetet Rome, Jevgjite dhe Endacake te cilet jane bashkepunetore dhe perdorues te sherbimeve arsimore qe ishin ne diskutim. Pikpamjet dhe eksperiencat e femijve Rome, Jevgjiteve dhe Endacake si dhe eksperiencat e te rinjve, prinderve dhe mesuesve, jane shume te rendesishme per konkluzionet dhe rekomandimet qe u parashtruan ne raportin final me titull Pse te mohohet nje e Ardhme.

## **PER CILET VLEN RAPORTI ME TITULL PSE TE MOHOHET NJE E ARDHME**

Ky raport perfshin nje Permbledhje, nje Manual Legjislativ Nderkombetar dhe dy volume Raportesh sipas vendeve perkatese. Manuali legjislativ nderkombetar pershkruan kuadrin ligjor, rajonal dhe nderkombetar qe garanton te drejten e arsimit per femijet e grupeve te minoriteteve. Volumi 1( i pare) i raporteve te vendeve mbulon Evropën juglindore dhe Volumi 2 ( i dyte) mbulon Evropën Qendrore dhe Perendimore. Ka permbledhje per secilin raport te çdo vendi si edhe permbledhje volumesh qe japin mundesi per reference te shpejte dhe per nje gjetje te lehte per informacionin. Permbledhja identifikon konkluzionet kryesore per raportet e katermbedhjete vendeve: Konkluzionet e Save the children dhe rekomandimet per aktivitet ne te ardhmen.

Ne shpresojme qe lexues te ndryshem ta perdorin raportin me titull Pse te mohohet nje e ardhme ne menyre te ndryshme. Per Organizatat Joqeveritare Lokale dhe Nderkombetare ne shpresojme se ky material do te jete mjet i dobishem ndihme dhe konsulence. Ne manualin legjislativ nderkombetar ligjet dhe nenet shpjegohen dhe analizohen dhe gjithashtu pershkruhen dhe mekanizmat kontrolluese qe kane lidhje me to. Secili raport lokal permban nje paragraf qe tregon instrumentat ligjore nderkombetare qe jane ratifikuar ne ate vend. Si nje mjet praktik keshillimi dhe konsulence raporti me titull Pse te mohohet nje e ardhme permban shume informacion qe u nevoitet Organizatave Joqeveritare te cilat jane te interesuara per te perdorur ligjin nderkombetar per te organizuar ndryshim ne nivel kombetar dhe komunitar. Ne shpresojme se ky raport do te perdoret gjeresisht si burim planifikimi dhe informacioni nga stafe te ndryshme dhe vullnetare qe punojne ne agjensit nderqeveritare si edhe nga organizatat joqeveritare nderkombetare. Raportet e perpiluara nga secili vend japin nje pasqyre te pergjithshme te ligjshmerise dhe politikave, gjithashtu dhe nje pershkrim te hollesishem te situates ne shkolla dhe komunitete si dhe pikpamjet e nxenesve, prinderve dhe mesuesve. Ato gjithashtu japin informacion per komunitetet e ndryshme te Romeve, Jevgjiteve dhe Endacakeve, historite e tyre si dhe gjuhete qe ato flasin. Ne secilin raport ka nje sere rekomandimesh qe Save the Children beson se do te behen fokusi per vemendje dhe veprimtari te metejshme.

Ne shpresojme se politikeberesit do ta gjejne raportin me titull : Pse te mohohet nje e ardhme si nje burim te rendesishem informacioni rreth zhvillimeve ne vendet e tjera Evropiane. Eshte zhvilluar nje praktike shume e mire e cila mund te shkallezohet me tej

dhe mbi të cilën mund të bazohesh. Megjithatë disa nga raportet e vendeve mbajnë qëndrim kritik ndaj punës së qeverisë, qëllimi i botimit të raportit me titull *Pse të mohohet një e ardhme* është konstruktiv.

Ne jemi të ndergjegjshëm se ka pengesa të shumta financiare si dhe pengesa të tjera që pengojnë zbatimin e politikave dhe gjithashtu jemi të ndergjegjshëm se shumë iniciativa pozitive janë duke vepruar por këto iniciativa kanë marrë udhë vetëm këto kohë e fundit, kështu që është akoma tepër herët për të identifikuar rezultatet. Qëllimi ynë në publikimin e këtij raporti është të tregojmë se ku duhet që qeveritë të fokusojnë përpjekjet e tyre sepse veprimet e tyre janë kaq të rëndësishme për zgjidhje. Megjithatë raportet e secilit vend tregojnë gjithashtu se në çfushë duhet të veprojnë profesionistët, praktikantët, organizatat joqeveritare, drejtuesit dhe aktivistët e komunitetit.

*Kufizimet e raportit me titull *Pse të mohohet një e ardhme*?*

Duhet të njohim që në fillim faktin se raporti me titull *Pse të mohohet një e ardhme* nuk është fjala e fundit lidhur me çështjen e të drejtës për arsim të femijve Rome, Jevgjite dhe Endacake. Në disa vende ka qenë e vështirë të sigurohesh informacion i besueshëm, megjithatë në rastet kur ne kemi menduar se kishte mundësi për një përpjekje ose kur na është dhënë informacion i kontestueshëm ose i vjetëruar, ne kemi bërë kërkime të metejshme dhe jemi përpjekur të gjejmë përkrahje alternative. Nuk kemi arritur të gjejmë asnjë informacion sa do të desheronim lidhur me problemin se si gjinia e femijes influencën në marrjen e vendimeve për arsimin. Gjithashtu çështja e rëndësishme e diskriminimit të punës së tregut del jashtë parametrave të këtij raporti.

Raporti me titull *Pse të mohohet një e ardhme* parashikon një veshtrim të shpejtë për një periudhë dinamike. Gjithashtu koordinatoret e projektit kanë bërë shumë përpjekje për të siguruar që informacioni të jetë sa më bashkëkohor që të jetë e mundur, madje dhe brenda periudhës disa muajore kur bëhet punë kërkimore edhe materiali duhet çuar për shtyp dhe iniciativat dhe politikat e reja duheshin përfshirë në të. Kjo përpjekje duhet përshëndetur. Ne shpresojmë se ekzistenca e këtij raporti e lehtëson punën e njerezve për të identifikuar ku dhe si po ndryshojnë gjërat për më mirë.

## **SI KEMI PERZGJEDHUR VENDET PËR PËRPILIMIN E RAPORTIT PSE TË MOHOHET NJË E ARDHME**

Shumë njerëz na pyesin si i kemi zgjedhur në 14 (katërmbëdhjetë) vendet që përfaqësohen në raportin me titull *Pse të mohohet një e ardhme*. *Save the children* në Angli dhe programi i Evropës vepron në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Evropën Juglindore. Natyrisht për qëllimet tona ne ishim veçanërisht të interesuar për situatën në këto vende. Ne donim të përfshinim raporte nga shtetet e tjera antare të Bashkimit Evropian, me qëllim që të terhiqnim vëmendjen lidhur me çështje që duheshin trajtuar – Mohimi i të drejtës për arsim për femijë të etiketuar si Jevgjite, konceptohet shpesh në mënyrë të gabuar si problem që kufizohet vetëm për Evropën Qendrore dhe Juglindore. Organizata partnere në Itali, Finlandë dhe Greqi na ndihmuan për përgatitjen e raporteve për këto vende. Për fat të keq për mungesë kohe dhe burimesh në dispozicionin tonë në

nuk mundem ta shtrinin kete pune edhe per vende te tilla si per shembull Spanje, Gjermani, Irlande, Poloni, Slloveni, Vende Balltike ose Rusi. Ne kemi perfshire Raporte per republiken Çeke, Sllovaki dhe Hungari sepse ne keto vende ndarja midis femijeve Rome dhe Cigane nga femijet e tjere dhe praktika e arsimimit te tyre ne shkolla te veçanta, per femijet me paaftesi mendore paraqet nje sfide. Kush jane femijet ne fotografi?

Shumica e femijeve qe shihen ne raportin me titull pse te mohohet nje e ardhme jane mare nga komunitete Romesh, Ciganesh dhe Endacakesh ne Bosnje dhe Hercegovine, Hungari, Itali, Serbi, Rumani dhe Çales ne veren e vitit 2001. Raportet pasqyrojne edhe pamje nga arkivi i fotografit, nga vende te tjera duke perfshire edhe republiken Çeke, Angline, Polonine dhe Sllovakine.

Si rregull, femijet dhe te rinjte moren pjese direkt ne procesin e fotografimit. Ne shume raste ata kerkonin te fotografoheshin krahas sendeve dhe njerezve qe ishin te rendesishem per ta: vellezer, motra, miq, kafshe shtepiake, lodra dhe vende ku ata luajne dhe punojne. Fotografi, Poppy Szabyo ka punuar si fotograf dokumentar dhe organizator i projekteve kulturore dhe arsimore me Romet, Ciganet dhe Endacaket ne te gjithe Evropen per me shume se dhjete vjet. Ajo falenderon te gjithe komunitetet qe ajo ka vizituar ne veren e vitit 2001 per miresjelljen e tyre bujarine, dhe mikpritjen. Veçanerisht ajo do te donte te falenderonte te rinjte me te cilet punoi dhe fotografoi dhe me te cilet ndau humorin e tyre, energjine, vitalitetin dhe ngrohtesine duke e bere projektin me titull: Pse te mohohet nje e ardhme nje projekt frymezues dhe te paharrueshem.

**Translation was enabled by U.S. Democracy Commission Grant**